RIDEA Research Institute of Development and European Affairs

ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA (OKB): PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT

Nëntor **2019**

Mbështetur nga: Norwegian Embassy

Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10

Prishtinë, 10000

Republika e Kosovës

T/F: +383 38 746 206

E-mail: ridea.institute@gmail.com

Website: www.ridea-ks.org

STUDIM:

ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA (OKB): PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT

Nëntor 2019

STUDIM:

ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA (OKB): PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT

Ky studim u mbështet nga:

Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Nëntor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat i

I. Hyrje 1

II. Anëtarësimi në OKB: Dispozitat Përkatëse 2

III. 'Shteti' 3

(1) Popullsi e përhershme 5

(2) Territor i përcaktuar 6

(3) Qeveria 9

(4) Aftësia për të Hyrë në Marrëdhënie me Shtete të tjera 10

IV. Kriteret e Vendimit për Pranimin e anëtarëve të rinj: Kërkesat thelbësore dhe procedurale 11

A. Kërkesat Thelbësore 12

B. Kërkesat Procedurale 14

C. Pranimet e fundit në Anëtarësimin e OKB-së dhe Kosova 16

V. Procesi praktik i aplikimit: Rregullorja e procedurës së Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme 18

VI. Përfundimet dhe Rekomandimet 19

Shkurtesat

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
MGJP	Marrëveshja Gjithëpërfshirëse e Paqes

I. Hyrje

Ky studim tenton të artikulojë një vizion gjithëpërfshirës të konsideratave ligjore dhe të politikave që përcaktojnë përpjekjet për anëtarësim në Kombet e Bashkuara. Duke vepruar kështu, studimi identifikon së pari dispozitat përkatëse në sistemin ligjor të OKB-së që drejton procesin e pranimit të anëtarëve të rinj në OKB. Kriteri kryesor ose i domosdoshëm për anëtarësimin në OKB është që kandidati është 'Shtet'. Çfarë nënkupton Shteti në kuptimin tradicional të së drejtës ndërkombëtare, por edhe në terma më funksional, nëse jo në termat jo-tradicional, do të përbëjë një pjesë kryesore të diskutimit të ofruar në Seksionin III të studimit. Në fund të diskutimit për secilin kriter të përbërë dhe substancës përkatëse, ekziston një analizë për mënyrën sesi Kosova e përmbush atë.

Tjetra, në Seksionin IV, ekziston një diskutim i detajuar rreth të drejtës materiale dhe kritereve thelbësore për anëtarësim dhe aspekteve procedurale të procesit që karakterizon marrjen e vendimit për pranimin e një anëtari të ri në Kombet e Bashkuara. Seksioni V pastaj ofron një përshkrim të procesit praktik të aplikimit, duke shikuar dispozitat përkatëse të Rregullores së Procedurës së të dyjave: Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Seksioni VI paraqet përfundimet dhe rekomandimet.

II. Anëtarësimi në OKB: Dispozitat Përkatëse

Dy dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara për anëtarësim në OKB janë të përcaktuara në Nenet 3 dhe 4 dhe kanë përmbajtjen e mëposhtme:

> *Neni 3. Anëtarët fillestarë të Kombeve të Bashkuara do të jenë shtetet të cilat, pasi kanë marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Organizatën Ndërkombëtare në San Francisko, ose që kanë nënshkruar më parë Deklaratën e Kombeve të Bashkuara të 1 janarit 1942, të nënshkruajnë Kartën aktuale dhe ratifikojnë atë në përputhje me Nenin 110.*[1]
>
> *Neni 4 (1). Anëtarësimi në Kombet e Bashkuara është i hapur për të gjitha shtetet e tjera paqedashëse që pranojnë detyrimet e përfshira në Kartën aktuale dhe, janë të aftë dhe të gatshëm t'i kryejnë këto obligime.*[2]
>
> *Neni 4 (2). Pranimi i çdo shteti të tillë për anëtarësim në Kombet e Bashkuara do të kryhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme me rekomandimin e Këshillit të Sigurimit.*[3]

Neni 3 flet për anëtarët fillestarë të OKB-së, ndërsa Neni 4(1) flet për të gjitha shtetet e tjera që përmbushin kriteret dhe dëshirojnë të bashkohen në organizatë. Në secilin rast, kriteri thelbësor dhe i domosdoshëm është që kandidati është shtet ose që organizata është e hapur për shtetet.

Megjithatë, Karta nuk përcakton termin 'Shtet' ose 'Shtete' dhe as dy mendimet këshilluese të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me anëtarësimin në Kombet e Bashkuara

[1] Karta e Kombeve të Bashkuara, (1945), 'Neni 3'. E disponueshme: https://www.un.org/en/sections/un-charter/chapter-ii/index.html [Qasur më: 15 tetor 2019].
[2] Po aty. neni. 4, par. 1.
[3] Po aty. neni. 4, par. 2.

(*do të thotë., Kushtet e Pranimit të një Shteti për Anëtarësim në Kombet e Bashkuara* të vitit 1948 dhe *Kompetenca e Asamblesë së Përgjithshme për Pranimin e një Shteti në Kombet e Bashkuara* të vitit 1950). Në praktikë, vendimmarrësit duket se kanë ndjekur një numër kriteresh dhe kanë dhënë një shumëllojshmëri kuptimesh të termit.[4]

III. 'Shteti'

Përkufizimi tradicional i shteteve në të drejtën ndërkombëtare ka të bëjë me entitetin si shtet nëse ka (a) një popullsi të përhershme; (b) një territor të përcaktuar/definuar; (c) qeverinë; dhe (d) aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtete të tjera. [5]Këto kritere janë kodifikuar në atë që njihet si Konventa e Montevideos për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve.

Megjithatë, termi/nocioni shtet në praktikën e OKB-së lidhur me pranimin e anëtarëve të rinj nuk i është dhënë një kuptim i njëjtë, por në vend të kësaj një numër kuptimesh të thjeshta diskutabile. Një entitet mund të duket sikur bie ndesh me shtetësinë në një lidhje të rëndësishme apo tjetrën, por mbahet si një shtet i pranueshëm për anëtarësim. Anasjelltas, një entitet mund të duket se është i kualifikuar si shtet, por i refuzohet statusi i shtetësisë që mbetet i papranueshëm për anëtarësim.

Nën këtë praktikë, shteti mund të nënkuptohet si një entitet i pavarur dhe sovran, një nënndarje politike, një posedim të një shteti jashtë shtetit, një territor të mandatuar, një entitet me një shkallë të pasigurtë të pavarësisë, një entitet me një qeveri të kontrolluar në shkallë të ndryshme nga një qeveri tjetër, një entitet pa një qeveri, një entitet me një territor të kontestuar, e kështu me rradhë. [6]

[4] Frederick Tse-shyang Chen (2001) 'The Meaning of "States" in the Membership Provisions of the United Nations Charter', *Indiana International & Comparative Law Review (Vol 12, No.1), fq.25*.
[5] Po aty.
[6] Po aty, fq.26

Që në fillim të vitit 1948, një autoritet i respektuar i të drejtës ndërkombëtare dhe më pas Zëvendës Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit, Philip Jessup, bëri vërejtjen e mëposhtme për njëtrajtshmëri:

> *Është e zakonshme që, ndonëse ka përkufizime tradicionale të një Shteti në të drejtën ndërkombëtare, termi është përdorur në mënyra të ndryshme. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se, nën përkufuzimin tradicional të një Shteti në të drejtën ndërkombëtare, të gjithë autorët e mëdhenj kanë treguar katër kualifikime: së pari, duhet të ketë një popull; së dyti, duhet të ketë një territor; së treti, duhet të ketë një qeveri; dhe, së katërti, duhet të ketë aftësi për të hyrë në marrëdhënie me Shtetet e tjera të botës.*
>
> ***...*** *[Por] termi 'Shtet', siç përdoret dhe zbatohet në Nenin 4 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, mund të mos jetë tërësisht identik me termin 'Shtet' siç përdoret dhe përkufizohet në tekstet klasike të së drejtës ndërkombëtare.*[7]

Në praktikën përkatëse të Kombeve të Bashkuara, është vërejtur përkufizimi tradicional, megjithatë është operacionalizuar në një grup të konsideratave specifike. Për shembull, është raportuar se Këshilli i Sigurimit ka marrë parasysh faktorët e mëposhtëm kur vepron në aplikimet për anëtarësim:

> *Në lidhje me shtetësinë e kandidatit, referenca është bërë për çështje të tilla si në vijim: Posedimi ose mungesa e kufinjve të vendosur; mënyra e krijimit të Shtetit; marrja e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme; ... marrëdhëniet me një ish- shtet Sovran; ... nevoja e ratifikimit të traktateve të paqes me ish-armiqtë kandidatë; aftësitë e kufizuara që rezultojnë nga Lufta e Dytë Botërore; legjitimiteti i shtetësisë të fituar nëpërmjet agresionit dhe pushtimit; marrëveshjet e mbrojtjes me kompetenca të tjera; statusi de jure ose de facto i*

[7] Po aty, fq.28-29.

kandidatit dhe i Qeverisë së tij; njohja e kandidatit nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara; ruajtja e marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e tjera.[8]

Deklarata e mësipërme tregon për një numër faktorësh që në thelb kërkojnë të masin dhe të verifikojnë praninë ose mungesën e kritereve të kërkuara të shtetësisë.

Sidoqoftë, vlen të shqyrtohet secili nga kriteret e përdorura në konceptin tradicional të termit/nocionit 'Shtet'. Theksi do të jetë në aplikimet relativisht të ndryshueshme dhe në shumëllojshmërinë e kuptimeve të pa ndara të secilit kriter.

(1) Popullsi e përhershme

Kriteri i parë i listuar në Konventën e Montevideos është ai i një popullsie të përhershme njerëzore si parakusht për ekzistencën e një shteti. Aplikimet për pranim në OKB rrallëherë janë sfiduar për shkak të mungesës së një popullsie të përhershme.

Megjithatë, 'përbërja' e popullsisë së një kandidati është ngritur për të sfiduar shtetësinë e saj, por sfidat nuk dukeshin që çonin diku. Çështja e përbërjes ndoshta ishte ngritur me mendimin se të huajt që banonin në një shtet pretendues, duke qenë atje në vuajtje, nuk ishin pjesë e popullsisë së saj të përhershme**.** Vendimi nënkupton se për aq kohë sa një kandidat kishte një popullsi të përhershme, pavarësisht nëse përbënte një minoritet ose një shumicë të të gjithë atyre që jetonin në territorin e tij, ai plotësonte kërkesën e shtetësisë. Një ilustrim është aplikimi i Kuvajtit. Kur Kuvajti aplikoi në vitin 1961, përfaqësuesi i Irakut diskutoi çështjen e kushtetutës të popullsisë së kandidatit në Këshillin e Sigurimit si më poshtë:

[8] Departamenti i OKB-së për Çështje të Këshillit Politik dhe të Sigurisë, Repertori i Praktikës së Këshillit të Sigurimit. 1946-1951, 272-73 (1954). E disponueshme: https://www.un.org/en/sc/repertoire/46-51/46-51_07.pdf [Qasur më: 15 tetor 2019].

I gjithë territori ka një popullsi prej rreth 250,000 banorë, prej të cilëve më shumë se 60 përqind jetojnë në qytetin e Kuvajtit. Popullsia jashtë qytetit është e përbërë kryesisht nga nomadët të cilët rëndom kalojnë nëpër shkretëtirat e gjera që shtrihen nga vendet më jugore të Irakut në zemër të gadishullit Arab. Në qytetin e Kuvajtit, i cili është qendra e vetme e popullsisë në territorin e kontrolluar nga Sheikët, shumica e banorëve konsiderohen nga vetë Sheikët si të huaj, prandaj u mohohet e drejta dhe privilegjet e akorduara normalisht për qytetarët.[9]

Bashkimi Sovjetik vuri veton ndaj aplikimit të Kuvajtit në bazë të dështimit të këtij të fundit për të përmbushur kërkesat e shtetësisë. Kuvajti riaplikoi dy vite më vonë, dhe këtë herë Këshilli i Sigurimit votoi njëzëri për të rekomanduar pranimin. Meqenëse në procesverbal nuk kishte asnjë indikacion se përbërja e popullatës së Kuvajtit kishte pësuar ndonjë ndryshim domethënës që nga aplikimi i parë, duhet të jetë rasti që Kuvajti të mund të cilësohej se kishte përmbushur kërkesën e një popullsie të përhershme edhe pse shtetasit e tij përbënin vetëm një pakicë të banorëve të saj. Nëse Kuvajti ishte shtet në vitin 1963, ai duhet të ketë qenë një shtet gjithashtu në vitin 1961. Me pak fjalë, 'një popullsi e përhershme' duket të nënkuptoj një popullsi e përhershme e cila mund të jetë jo më shumë se një pakicë e atyre që jetojnë në territorin e një shteti pretendues.

Nuk ka dyshim, faktik ose tjetër, në lidhje me këtë kriter se Kosova e përmbush atë.

(2) Territor i përcaktuar

Një shembull i shquar në lidhje me kërkesën formale të një territori të përcaktuar është rasti i Izraelit. Një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme propozoi themelimin e një shteti Arab dhe një shteti Hebre në Palestinë duke ndarë mandatin e atëhershëm britanik mbi kundërshtimin e shteteve Arabe dhe shteteve të tjera Islamike në bazë të vetëvendosjes. Në atë kohë, popullsia e territorit të mandatuar ishte dy të tretat popullsi Arabe dhe një e treta

[9] Shih fusnotën 4, fq. 29.

Hebreje. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nuk ishte zbatuar. Më 14 maj, të vitit 1948, një ditë para përfundimit të shpalljes së mandatit, u shpall Shteti i Izraelit. Më vonë në të njëjtin vit, Izraeli aplikoi për pranim. Përderisa Komiteti i Parë i Asamblesë së Përgjithshme po diskutonte të ardhmen e Palestinës, Këshilli i Sigurimit veproi sipas kërkesës së Izraelit.[10]

U ngritën pyetje lidhur me territorin e Izraelit. Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara e karakterizoi këtë çështje si një nga çështjet me 'kufinjtë e padefinuar' vetëm, e cila nuk do të shkelte kërkesën e një territori të përcaktuar, dhe jo një prej 'territori të papërcaktuar', i cili do ta shkelte atë, dhe shpjegoi:

> *Askush nuk gjen në trajtimin e përgjithshëm klasik të kësaj teme ndonjë insistim që territori i një Shteti duhet të përcaktohet saktësisht nga kufinjtë e caktuar…Formulat në traktatet klasike ndryshojnë disi, njëra nga tjetra, por të dyja si arsyeja ashtu dhe historia vërtetojnë se koncepti i territorit nuk përfshin domosdoshmërisht përcaktimin e saktë të kufinjve të atij territori. Arsyeja për rregullin që një nga tiparet e nevojshme të një Shteti është se ai do të zotëroj territorin është se nuk mund të mendojmë për një Shtet të jetë si një lloj shpirti i lirë. Historikisht, koncepti është një insistim që atje duhet të ketë një pjesë të sipërfaqes së tokës, në të cilën populli i saj banon dhe mbi të cilën qeveria e saj ushtron autoritet. Askush nuk mund të mohojë se shteti i Izraelit i përgjigjet kësaj kërkese.*[11]

Përfaqësuesi i Bashkimit Sovjetik argumentoi se ishte e gabuar të vihej në dyshim territori i Izraelit si i papërcaktuar, pasi 'territori i tij është përcaktuar qartë nga një vendim ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara, përkatësisht me rezolutën e miratuar më 29 nëntor të vitit 1947 nga Asambleja e Përgjithshme'.

[10] Po aty, fq.30-31.
[11] Po aty, fq.31.

Në anën tjetër, përfaqësuesi i Mbretërisë së Bashkuar, në ish-mandatin e tij në Palestinë, mendoi qartë se situata e Izraelit ngriti një çështje të territorit të papërcaktuar, duke deklaruar se: 'Fati përfundimtar ose të paktën forma përfundimtare e Shtetit të Izraelit ende mbetet të përcaktohet dhe nuk dihet ende'. Përfaqësuesi i Sirisë u ndje në të njëjtën mënyrë, duke deklaruar se: 'Shteti i Izraelit nuk ka territor që nuk kontestohet. Shtetet Arabe dhe të gjitha Shtetet fqinje të Lindjes së Afërt kundërshtojnë ekzistencën e atij Shteti; nuk janë vetëm kufinjtë e tij që ata kundërshtojnë, por ekzistencën e vet Shtetit'.[12]

Sidoqoftë, Izraeli u pranua në Kombet e Bashkuara vitin e ardhshëm, 1949, pasi kishte deklaruar gatishmërinë e tij për të përmbushur një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme për ndërkombëtarizimin e Jerusalemit dhe për refugjatët arabë që rezultojnë nga një luftë ndërmjet Izraelit dhe pesë shteteve arabe në vitin 1948. Izraeli sigurisht që nuk është shembulli i vetëm.[13] Duke marrë fqinjësinë rajonale, Shqipëria në kohën e shpalljes së pavarësisë së saj do të përfaqësonte një shembull tjetër.

Si përmbledhje, një territor i caktuar duket se nënkupton një territor të pa definuar. Megjithatë, kur bëhet fjalë për Kosovën, është përtej çështjes se ajo përmban një territor të përcaktuar. Pozicioni më artikulues dhe autoritativ ofrohet në Planin e të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së, Marti Ahtisaari. Shtojca VIII e Planit të Ahtisaarit përcakton se 'territori i Kosovës do të përcaktohet nga kufinjtë e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç këta kufinjë qëndruan më 31 dhjetor 1988, me përjashtim të ndryshimit me marrëveshjen e ndarjes së kufirit ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt 2001'. Po ashtu, Deklarata e Pavarësisë së Kosovës qartëson se "Kosova do të ketë kufinjtë e saj ndërkombëtarë siç është përcaktuar me Shtojcën VIII të Planit të Ahtisaarit."

[12] Po aty, fq.31.
[13] Po aty, fq.31.

(3) Qeveria

Ngjashëm me 'territorin e përcaktuar', kriteri i 'qeverisë' nuk është interpretuar në mënyrë shumë strikte. Një ilustrim interesant është rasti i aplikimit të Principatës së Monakos. Territori i Principatës përfshinte 1.95 kilometra katrorë. Prej një popullsie të përgjithshme prej 31,693, përbërja etnike ishte 40 përqind francezë, 16 përqind monegaskë, 16 përqind italianë, dhe 21 përqind të tjerë. Sipas një traktati me Francën në vitin 1918, Monako, në këmbim të mbrojtjes së Francës, ndërmorri të kufizonte si kushtetutën ashtu edhe funksionimin e qeverisë së saj. [14]

Masat e Monakos në lidhje me ushtrimin e një regjimenti ose një suksesioni në fron janë gjithmonë subjekt i konsultimeve paraprake me Francën, dhe froni mund të kaloj vetëm tek një shtetas francez ose monegas. Përderisa Princi është Kreu i Shtetit, kreu i qeverisë është Ministri i Shtetit, i cili emërohet nga Princi nga një listë prej tre shtetasve francezë të zgjedhur nga qeveria franceze. Midis tre Këshilltarëve të Qeverisë, Këshilltari i Brendshëm kërkohet të jetë shtetas francez. Sa i përket funksionimit të qeverisë, Monako duhet të ushtroj sovranitetin e tij në përputhshmëri të plotë me interesat politike, ushtarake, detare dhe ekonomike të Francës. Përmasat e Monakos në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare janë gjithmonë subjekt i konsultimeve paraprake me qeverinë franceze. Qeveria e Francës mundet, me mocionin e vet, të dërgoj forca ushtarake ose detare në territorin e Monakos për ruajtjen e sigurisë së të dyja vendeve.[15]

Sipas regjimit të traktateve, qeveria e Monakos dhe qeverisja e tij i nënshtrohen dukshëm kontrollit substancial nga Franca. Kështu, principata duket se gëzon një shkallë të pasigurtë të shtetësisë. Sidoqoftë, në vitin 1993, përderisa regjimi i traktateve të vitit 1918 mbeti në thelb i paprekur, kërkesa e Monakos për pranim u rekomandua nga Këshilli i Sigurimit pa votim dhe u miratua nga Asambleja e Përgjithshme gjithashtu njëzëri. Regjistrimet zyrtare nuk tregojnë të ketë pasur diskutime për çështjen e shtetësisë.

[14] Po aty, fq.32.
[15] Po aty.

Në përgjithësi, qeveria duket se nënkupton një qeveri e përbërë me ose pa ndikim të huaj dhe më shumë ose më pak vetëqeverisje. Tani në dekadën e dytë që nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka dhe qeveriset nga një qeveri dhe sigurisht që e plotëson këtë kriter.

(4) Aftësia për të Hyrë në Marrëdhënie me Shtete të tjera

Në vitin 1948, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara shprehën se:

> *Për sa i përket çështjes së aftësisë për të hyrë në marrëdhënie me Shtetet e tjera të botës, argumentet e mësuara akademike mund të bëhen dhe janë bërë për efektin që tashmë kemi, midis Anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, disa subjekte politike të cilat nuk posedojnë liri të plotë sovrane për të formuar politikën e tyre ndërkombëtare, e cila tradicionalisht është konsideruar karakteristikë e një Shteti. Ne e dimë, megjithatë, se as në San Francisko e as më pas Kombet e Bashkuara nuk e kanë konsideruar atë liri të plotë për të krijuar dhe menaxhuar politikën e tyre të jashtme e cila ishte kushti kryesor për anëtarësim në Kombet e Bashkuara.*[16]

Në kohën kur kjo vërejtje(theksim) është bërë, fraza 'disa entitete politike' ndoshta kishte të bënte me disa anëtarë fillestarë të cilët nuk ishin shtete sovrane. Shumë anëtarë pasues gjithashtu tregojnë mungesën e lirisë së plotë në përcaktimin dhe zbatimin e politikave të tyre të jashtme. [17]

Për një ilustrim të zbatimit fleksibil të këtij kriteri ndaj një kandidati që nuk është as anëtar fillestar e as një shtet i ri i pavarur, ne mund të rikthehemi në rastin e Monakos të diskutuar më parë. Sipas regjimit të njëjtë të traktateve të themeluar në vitin 1918, është e qartë se Monako nuk gëzon të drejta sovrane në marrjen dhe zbatimin e politikave të saj të jashtme. Kjo bëri që një vërejtje që nëse Monako do të kishte aplikuar për pranim në vitin 1961, aplikimi i tij do të dështonte për shkak të mungesës së shtetësisë. Megjithatë, Monako u

[16] Po aty, fq.33.
[17] Po aty, fq.33.

pranua pa shqyrtim në vitin 1993, edhe pse pak kishte ndryshuar rreth aftësisë së Monakos për të kryer marrëdhëniet e saj të jashtme ndërmjet viteve 1961 dhe 1993.[18]

Me pak fjalë, aftësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera duket se nënkupton aftësinë, pak a shumë të kufizuar, për të hyrë në këto marrëdhënie. Kosova ka demonstruar aftësinë e saj për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera. Ajo ka treguar aftësitë e saj në disa mënyra: nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve të panumërta ndërkombëtare, vendosjes së marrëdhënieve diplomatike dhe mirëmbajtjes së rreth tridhjetë (30) misioneve diplomatike jashtë vendit dhe ngjashëm duke mirëpritur misione të tilla diplomatike në shtëpi, si dhe nëpërmjet anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, qoftë organizata rajonale të përcaktuara më ngushtë, me bazë Evropiane siç është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ose Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës, apo organizata të gjera ndërkombëtare, siç është Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, ku të dyja janë edhe agjenci të specializuara të OKB-së.

IV. Kriteret e Vendimit për Pranimin e Anëtarëve të Rinj: Kërkesat thelbësore dhe procedurale

Siç u përmend në fillim të këtij studimi, dispozita përkatëse që drejton pranimin e anëtarëve të rinj në Kombet e Bashkuara është Neni 4 i Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ajo liston të dyja kërkesat thelbësore, të parashtruara në paragrafin 1, dhe hapat procedural të nevojshëm, të detajuar në paragrafin 2 të së njëjtës dispozitë. Në tërësi, thuhet:

1. *Anëtarësimi në Kombet e Bashkuara është i hapur për të gjitha shtetet e tjera paqedashëse që pranojnë detyrimet e përfshira në Kartën aktuale dhe, sipas gjykimit të Organizatës, janë të aftë dhe të gatshëm t'i kryejnë këto detyrime.*

[18] Po aty, fq. 34.

2. *Hyrja e ndonjë shteti të tillë për anëtarësim në Kombet e Bashkuara do të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas rekomandimit të Këshillit të Sigurimit.*

A. Kërkesat Thelbësore

Kërkesat thelbësore janë pesë në numër: për t'u pranuar në anëtarësimin e Kombeve të Bashkuara, kandidati duhet (1) të jetë shtet; (2) të jetë paqedashës; (3) të pranoj detyrimet e Kartës; (4) të jetë i aftë t'i kryejë këto detyrime; dhe (5) të jetë i gatshëm t'i bëjë ato.

Ashtu siç Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e ka vënë mendimin këshilldhënës në rastin e *Kushteve të Pranimit të një Shteti për Anëtarësim në Kombet e Bashkuara* (1948) [këtej e tutje 'Kushtet e Pranimit'], të gjitha këto pesë kushte i nënshtrohen vendimit të Organizatës.[19] Vendimi i Organizatës nënkupton aktgjykimin e dy organeve të autorizuara nga, ose të përmendura në, paragrafin 2 të Nenit 4, dhe, në analizën e fundit, atë të anëtarëve të saj.

Një nga detyrat themelore të Gjykatës në këtë rast ka qenë përcaktimi i karakterit të këtyre kushteve; më saktësisht, nëse kjo listë e kushteve është e plotë apo jo.

Kuptimi i zakonshëm i fjalëve të përdorura në Nenin 4(1) e drejtoi Gjykatën në përfundimin se këto kushte përbëjnë një renditje të plotë dhe nuk janë thjesht të deklaruara me anë të udhëzimit ose shembullit. Dispozita do të humbiste rëndësinë dhe peshën e saj, nëse do të kërkoheshin kushte të tjera dhe të shkëputura me ato të përcaktuara më parë. Në analizën përfundimtare të Gjykatës, kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të Nenit 4 si pasojë do të konsiderohen jo vetëm si kushte të nevojshme, por edhe si kushte të mjaftueshme. [20]

[19] Pranimi i Shtetit në Kombet e Bashkuara (Kapitulli, Neni.4), Opinion Këshilldhënës: GJND.
[20] Po aty.

Gjykata konsideroi se teksti është mjaft i qartë, pasi që lista e kushteve është e plotë. Megjithatë, në vendimin e Gjykatës, nuk vijon nga karakteri i plotë i paragrafit 1 të Nenit 4 që vlerësimi është përjashtuar nga rrethana të tilla të fakteve që do të mundësonin ekzistencën e kushteve të nevojshme për t'u verifikuar.

Neni 4 nuk ndalon marrjen parasysh të ndonjë faktori i cili është i mundur në mënyrë të arsyeshme dhe me mirëbesim të lidhet me kushtet e përcaktuara në atë nen. Sipas Gjykatës, 'marrja në konsideratë e këtyre faktorëve nënkuptohet në natyrë shumë të gjerë dhe shumë elastike të kushteve të përshkruara; asnjë faktor i ngjashëm politik - që do të thotë, nuk ka lidhje me kushtet e pranimit- është përjashtuar'.

Gjykata ka arsyetuar gjithashtu se karakteri politik i një organi që merr vendimin (*do të thotë,* Këshilli i Sigurimit ose Asambleja e Përgjithshme) nuk mund ta lirojë atë nga zbatimi i dispozitave të traktatit të përcaktuara nga Karta kur ato përbëjnë kufizime në kompetencat e tyre ose kriteret e gjykimit të saj. Për të konstatuar nëse një organ ka liri zgjedhjeje për vendimet e tij, referenca duhet t'i bëhet kushteve të kushtetutës së saj. Në këtë rast, sipas Gjykatës, 'kufinjtë e kësaj lirie përcaktohen nga Neni 4 dhe lejojnë një liri të gjerë të vlerësimit. Prandaj nuk ka konflikt midis funksioneve të organeve politike, nga njëra anë, dhe karakterit të plotë të kushteve të përshkruara, nga ana tjetër'.

Në fund të fundit, Gjykata është e mendimit se një Anëtar i Kombeve të Bashkuara i cili është thirrur, në bazë të Nenit 4 të Kartës, të shpallë veten me votën e tij, qoftë në Këshillin e Sigurimit ose në Asamblenë e Përgjithshme, për pranimin e një shteti për anëtarësim në Kombet e Bashkuara, nuk ka juridikisht të drejtën për të dhënë pëlqimin e tij për pranim në varësi të kushteve që nuk janë parashikuar shprehimisht nga paragrafi 1 i këtij Neni.

Duke përfunduar këtë pikë, ndërsa vendimi i Gjykatës për karakterin e plotë të kushteve të parashikuara në Nenin 4 është i mirëpritur dhe duket se e diciplinon dhe e bën vendimin më objektiv, megjithatë njohja e Gjykatës që Shtetet, në marrjen e vendimeve të tyre gëzojnë 'lirinë e gjerë të vlerësimit' dhe se kushtet e përcaktuara definohen me një 'natyrë

shumë të gjerë dhe shumë elastike,' e bëjnë procesin më të paqëndrueshëm dhe të prirur ndaj vendimeve të kushtëzuara nga konsiderata të thella politike. Ashtu siç e ka shprehur një studiues autoritativ:

> *Në zbatimin praktik, Neni 4(1) me të vërtetë thotë pak më shumë sesa këta kandidatë do të pranohen që Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme (ose në aspektin politik, elitat efektive të botës) mendojnë se duhet të pranohen, një përfundim të cilin Gjykata Ndërkombëtare duket se e ka arritur në mënyrë indirekte dhe ndoshta me ngurrim...*[21]

B. Kërkesat Procedurale

Siç është thënë tani, paragrafi 2 i Nenit 4 të Kartës ka të bëjë me procedurën e pranimit, ndërsa paragrafi i mësipërm parashtron të drejtën thelbësore. Kur bëhet fjalë për kërkesat procedurale për pranimin e një anëtari të ri në OKB, vendimmarrësit janë Këshilli i Sigurimit, rekomandimi i të cilit është i detyrueshëm, dhe Asambleja e Përgjithshme, ku vendimi i së cilës ndikon në pranim. Pa rekomandimin pozitiv të Këshillit të Sigurimit, për shkak të votimit negativ ose mosveprimit nga Këshilli, një kërkesë nuk mund të shkojë përpara në Asamblenë e Përgjithshme dhe refuzohet për të gjitha qëllimet praktike derisa Këshilli përsëri e merr atë.

Meqenëse një vendim negativ i Këshillit të Sigurimit nuk i nënshtrohet rishqyrtimit, është në atë kuptim 'përfundimtar'. Kështu, sa herë që Këshilli i Sigurimit refuzon rekomandimin për një kandidat për shkak të mungesës së shtetësisë, ai vendim zyrtarisht jep kuptimin përfundimtar për termin/nocionin 'shtetet' në Nenin 4. Por një vendim pozitiv i Këshillit të Sigurimit për të rekomanduar, i cili është i nevojshëm përfshin një gjetje të favorshme mbi shtetësinë, nuk kontrollon Asamblenë e Përgjithshme, e cila ka të drejtë të marrë 'vendimin' e saj mbi shtetësinë e kandidatit/aplikantit. [22]

---

[21] W. Michael Reisman, (1973) 'Puerto Riko dhe Procesi Ndërkombëtar', fq. 54.
[22] Shih fusnotën 4, fq.46.

Ndërmjet dy organeve, Asambleja e Përgjithshme ka treguar të jetë më e gatshme të pranoj një kandidat për anëtarësim sesa Këshilli i Sigurimit. Asambleja e Përgjithshme ka ftuar në mënyrë të vazhdueshme Këshillin e Sigurimit për të rishqyrtuar kërkesat që ky i fundit ka refuzuar të rekomandoj dhe të miratoj rezoluta për të shprehur një opinion të favorshëm për kandidatët individual para shqyrtimit të tyre nga Këshilli i Sigurimit. Ishte zhgënjimi i Asamblesë së Përgjithshme për një Këshill të Sigurimit të bllokuar, i cili si pasojë nuk dha rekomandime për pranim, që përshpejtoi një përpjekje për të anashkaluar këtë të fundit dhe përfundimisht një mendim këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjykata sipas mendimit të saj në rastin e *Kompetencës së Asamblesës së Përgjithshme për Pranimin e një Shteti në Kombet e Bashkuara* (1950), deklaroi qartë se:

> *pranimi i një shteti për anëtarësim në Kombet e Bashkuara, në përputhje me paragrafin 2 të Nenit 4 të Kartës, nuk mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme kur Këshilli i Sigurimit nuk ka bërë asnjë rekomandim për pranim, për shkak të dështimit të kandidatit për të marrë shumicën e kërkuar ose votën negative të një Anëtari të përhershëm mbi një rezolutë që të rekomandojë.*[23]

Gjykatës i është bërë pyetja e mëposhtme nga Asambleja e Përgjithshme: *A mundet pranimi i një shteti për anëtarësim në Kombet e Bashkuara, sipas Nenit 4, paragrafit 2, të Kartës, të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme kur Këshilli i Sigurimit nuk ka bërë asnjë rekomandim për pranim për shkak të disfatës së kandidatit për të marrë shumicën e kërkuar ose votën negative të një anëtari të përhershëm mbi një rezolutë që të rekomandojë.*[24]

Në këmbim, sipas mendimit të Gjykatës, dispozita e Nenit 4(2) është e qartë dhe nuk ka dyshim në kuptimin e këtij teksti. Ajo kërkon dy gjëra: një 'rekomandim' të Këshillit të Sigurimit dhe një 'vendim' të Asamblesë së Përgjithshme. Në lidhje me këtë, Gjykata

[23] Po aty.
[24] Po aty.

arsyetoi se është në natyrën e gjërave që rekomandimi duhet të paraqitet përpara vendimit. Ajo vazhdoi më tej, duke deklaruar se:

> *Fjala 'rekomandim', dhe fjala 'sipas' para saj, nënkuptojnë idenë se rekomandimi është baza e vendimit për të pranuar, dhe se ky i fundit bazohet në rekomandim. Të dyja këto akte janë të domosdorshme për të formuar vendimin e Organizatës të cilës i referohet paragrafi i mëparshëm i Nenit 4. Teksti në shqyrtim nënkupton që Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të pranojë vetëm me rekomandimin e Këshillit të Sigurimit; ajo përcakton rolet përkatëse të dy organeve veprimi i së cilave kërkohet para pranimit; në fjalë të tjera, rekomandimi i Këshillit të Sigurimit është kusht precedent për vendimin e Asamblesë me të cilin bëhet pranimi.*

Me fjalë të tjera, veprimet e të dy organeve kërkohen, pavarësisht karakterit të tyre të ndryshëm: një rekomandim nga Këshilli i Sigurimit dhe, pas tij vetëm, vendimi nga Asambleja e Përgjithshme.

Kosova, kur të vendos të paraqes kërkesën/aplikimin e saj, duhet të ketë parasysh faktin se një rekomandin pozitiv nga Këshilli i Sigurimit është i pashmangshëm. Tjetra dhe në lidhje me aspektet procedurale të procesit, mund të jetë e dobishme të rishikoj dispozitat relavante të Rregullores së Procedurës së Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme.

C. Pranimet e fundit në Anëtarësimin e OKB-së dhe Kosova

Anëtari i fundit që iu bashkua Kombeve të Bashkuara është Sudani Jugor, që u anëtarësua në OKB në vitin 2011. Pavarësia e Sudanit Jugor është rezultat i referendumit të janarit 2011 të mbajtur nën kushtet e Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse të Paqes (MGJP) që përfundoi luftërat e gjata civile që zgjatën me dekada ndërmjet Veriut dhe Jugut. Në referendum, 98.83 përqind e pjesëmarrësve votuan për pavarësinë. Rezultati ishte i qartë

dhe gjithashtu i bazuar në një marrëveshje të ndërsjellë me Veriun, nuk pati kontestime ndërkombëtare të shtetit të ri. Kjo mund të reflektohet qartë në proceset që karakterizojnë anëtarësimin e tij në OKB.[25] Më 13 korrik 2011, Këshilli i Sigurimit i OKB-së i rekomandoi Asamblesë së Përgjithshme që Republika e Sudanit Jugor të pranohet në anëtarësim në OKB përmes një rezolute të cilën e miratoi unanimisht. Një ditë më pas, më 14 korrik 2011, Asambleja e Përgjithshme miratoi një rezolutë, me aklamacion, për të pranuar Sudanin Jugor në OKB.

Shteti që fitoi anëtarësimin në OKB para Sudanit Jugut është Mali i Zi, një ish republikë Jugosllave dhe fqinji i Kosovës. Mali i Zi u pranua në OKB më 28 qershor 2006, duke u bërë Shteti i 192-të anëtar i OKB-së. Kështu u pranua disa javë pasi fitoi pavarësinë e tij nga Serbia bazuar në, si Sudani Jugor, në një referendum, i cili ishte parashikuar në dokumentin kushtetues që qeveria e Unionit të Serbisë dhe Malit të Zi dhe kështu u pajtua gjithashtu nga Republika e Serbisë. Mali i Zi ishte pranuar gjithashtu në OKB me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me aklamacion, me rekomandimin e Këshillit të Sigurimit.

Timori Lindor, gjithashtu, nën administrimin e përkohshëm të OKB-së për ca kohë, është anëtar i OKB-së, i pranuar në organizatë si vendi i 191 anëtar në 27 shtator 2002. Pavarësia e Timorit Lindor ka qenë gjithashtu një rezultat i një referendumi popullor të miratuar më parë, i paraparë në një rezolutë detyruese të Këshillit të Sigurimit. Timori Lindor kështu është pranuar në OKB pa asnjë kundërshtim, përfshirë këtu edhe ish-fuqinë koloniale (Portugalia) dhe shtetin okupues (Indonezia).

Dallimi thelbësor midis Kosovës dhe këtyre vendeve, si dhe vendeve të tjera anëtare të OKB-së të pranuara më parë nga ish-Jugosllavia, është mungesa e një marrëveshje me shtetin e mëparshëm amë që ose parashikon njohje të ndërsjellë ose njeh rezultatet e një referendumi (si në rastet e Malit të Zi ose Sudanit Jugor).

[25] KB mirëpret Sudanin Jugor si shtetin e 193 anëtar (2011). E disponueshme: https://news.un.org/en/story/2011/07/381552. (Qasur me: 15 tetor 2019).

V. Procesi praktik i aplikimit: Rregullorja e procedurës së Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme

Kapitulli X i Rregullores së Procedurës së Këshillit të Sigurimit përshkruan kornizën që drejton shqyrtimin e kërkesës për anëtarësim në Kombet e Bashkuara.

Së pari, si një hap fillestar procedural, çdo Shtet i cili dëshiron të bëhet anëtar i OKB-së duhet të paraqes një kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm. Së bashku me kërkesën, Shteti duhet të bashkëngjes një deklaratë të bërë si një instrument formal që pranon detyrimet që përmban Karta (Rregulli 58).[26]

Rregulli 69 i Rregullores së Procedurës kërkon që sapo Sekretari i Përgjithshëm të pranoj kërkesën për anëtarësim, kjo kërkesë do të vendoset menjëherë përpara përfaqësuesve në Këshillin e Sigurimit. Përveç nëse Këshilli i Sigurimit vendos ndryshe, kërkesa i referohet Kryetarit të Këshillit deri tek komiteti i Këshillit të Sigurimit mbi të cilin përfaqësohet secili anëtar i Këshillit të Sigurimit. Komiteti pastaj shqyrton aplikacionin që i është referuar dhe i raporton përfundimet e tij mbi Këshillin jo më pak se tridhjetë e pesë ditë para seancës së rregullt të Asamblesë së Përgjithshme ose, nëse thirret një seancë e veçantë e Asamblesë së Përgjithshme, jo më pak se katërmbëdhjetë ditë përpara kësaj seance.

Pas shqyrtimit të Komitetit të Këshillit, Këshilli i Sigurimit më pas vendos nëse në vendimin e tij kandidati është Shtet paqedashës dhe është i aftë dhe i gatshëm të kryejë detyrimet e përmbajtura në Kartë dhe, në përputhje me rrethanat, nëse do të rekomandoj shtetin kandidat për anëtarësim. Nëse Këshilli i Sigurimit rekomandon shtetin kandidat për anëtarësim, ai i përcjell rekomandimin Asamblesë së Përgjithshme me një regjistër të plotë të diskutimit. Nëse Këshilli i Sigurimit nuk rekomandon Shtetin kandidat për anëtarësim

[26] Shih më shumë: 'Provisional Rules of Procedure - Chapter X: Admission of New Members'. E disponueshme: https://www.un.org/securitycouncil/content/rop/chapter-10 (Qasur me: 15 tetor 2019).

ose shtyen shqyrtimin e kërkesës, ai i paraqet një raport të veçantë Asamblesë së Përgjithshme me një regjistër të plotë të diskutimit.

Kjo çështje është adresuar, nga ana e saj, edhe në Rregulloren e Procedurës së Asamblesë së Përgjithshme, më saktësisht në Kapitullin XIV të Rregullores së Procedurës. Sipas Rregullores së Procedurës (Rregulli 136), nëse Këshilli i Sigurimit rekomandon Shtetin kandidat për anëtarësim, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtojë gjithashtu nëse kandidati është një Shtet paqedashës dhe është i aftë dhe në gjendje të kryejë detyrimet e përmbajtura në Kartë.

Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë sipas çdo kërkese për anëtarësim në Kombet e Bashkuara.

Në rast se Këshilli i Sigurimit nuk e rekomandon shtetin kandidat për anëtarësim ose shtyen shqyrtimin e kërkesës, Asambleja e Përgjithshme mundet, pas shqyrtimit të plotë të raportit të posaçëm të Këshillit të Sigurimit, të dërgojë kërkesën përsëri në Këshill, së bashku me një regjistër të plotë të diskutimit në Asamble, për shqyrtim të mëtejshëm dhe rekomandim ose raport.

Rregulli 138 detajon se është Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ai i cili informon Shtetin kandidat për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Nëse kërkesa aprovohet, anëtarësimi do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Asambleja e Përgjithshme merr vendimin e saj për kërkesën. [27]

VI. Përfundimet dhe Rekomandimet

Duke kaluar mbi shtetësinë e kandidatëve, dy organet e Kombeve të Bashkuara (Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme) duket se kanë respektuar një numër kriteresh

[27] Shih më shumë: 'Rules of procedure - XIV. Admission of New Members to the United Nations'. E disponueshme: https://www.un.org/en/ga/about/ropga/adms.shtml. (Qasur me: 15 tetor 2019).

autoritative të vendimit. Sigurisht, përkufizimi tradicional i të drejtës ndërkombëtare është një. Edhe kur i është nënshtruar aplikacioneve fleksibile, ky përkufizim ende vazhdonte të ndiqej zyrtarisht. Kjo është për shkak se përkufizimi tradicional, si të gjitha rregullat e tjera të ligjit, nuk është absolut dhe autonom. Konceptet teknike që përbëjnë këtë përkufizim, duke përfshirë atë të 'Shtetit', janë vetëm fjalë dhe fjalët nuk kanë kuptime të fiksuara. Ato tregojnë referenca absolute dhe të vazhdueshme dhe kështu mund të marrin kuptime të ndryshme. Kuptimi specifik që një vendimmarrës mund të jap në një rast të veçantë është një funksion i shumë variablave.

Megjithatë, është e qartë dhe lë përshtypje se Kosova përmbush të gjitha kriteret e kërkuara tradicionale të shtetësisë për qëllime të anëtarësimit në Kombet e Bashkuara, ndoshta në disa aspekte më mirë dhe më efektivisht sesa disa nga rastet e përmendura në këtë studim dhe të tjera të cilat në rrethana dhe pika të ndryshme në kohë kanë materializuar kërkesën e tyre për anëtarësim në OKB.

Kosova po ashtu përmbush pesë kërkesat thelbësore që janë përshkruar dhe kërkuar nga Neni 4(1) i Kartës së OKB-së që kërkon se një kandidat duhet të: (1) të jetë një Shtet; (2) të jetë paqedashës; (3) të pranoj detyrimet e Kartës; (4) të jetë i aftë t'i kryejë këto obligime; dhe (5) të jetë në gjendje t'i bëjë ato. Siç ka sqaruar GjND-ja, kjo listë e kushteve është e plotë. Megjithatë, sfida kryesore, posaçërisht për Kosovën, mund të jetë – siç njihet nga GjND-ja- 'liria e gjerë e vlerësimit' dhe 'natyra shumë e gjerë dhe shumë elastike' e vendimit që duhet të merret nga Anëtarët e Kombeve të Bashkuara, në veçanti dhe në rradhë të parë, nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të cilët kanë të drejtën e vetos për çdo vendim të tillë. Si rezultat i diskutimit të mësipërm, ka disa momente kritike që duhen marrë parasysh, që ofrohen më poshtë me anë të rekomandimeve:

1. Në ndërveprimet e tyre dypalëshe dhe shumëpalëshe, autoritetet e Kosovës do të duhet që të mbajnë një linjë të fuqishme argumenti—të mbështetur në ligj dhe fakt—se Republika e Kosovës i përmbushë kërkesat përmmbajtësore të anëtarësisë, të përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

2. Anëtarësimi i Kosovës në OKB duhet të jetë në kulmin e përparësive të politikave të Qeverisë dhe institucioneve të tjera, jo vetëm në letër dhe deklarime, por në veprime.

3. Para vendimit të saj për të paraqitur kërkesën për anëtarësim, lidershipi i Kosovës rekomandohet të studiojë mjedisin politik që rrethon anëtarët e Këshillit të Sigurimit, në veçanti anëtarët e përhershëm të cilët mund të kundërshtojnë rekomandimin për Kosovën për t'u anëtarësuar në OKB.

4. Sapo një rekomandim pozitiv për anëtarësim potencialisht të sigurohet nga Këshilli i Sigurimit, Kosova duhet të ketë marrë parasysh se vendimi përfundimtar për anëtarësim varet nga dy të tretat (2/3) e shumicës së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që janë prezent dhe që votojnë në atë seancë të veçantë.

5. Gjatë procesit dhe për qëllime të argumentit, autoriteteve të Kosovës gjithashtu u rekomandohet të studiojnë llojet e faktorëve që janë marrë parasysh në të kaluarën nga Këshilli i Sigurimit, me qëllim bindjen e anëtarëve hezitues ose rezistentë të Këshillit, si dhe çdo anëtari të tillë në Asamblenë e Përgjithshme. Disa nga faktorët që janë marrë parasysh në të kaluarën dhe potencialisht mund të merren parasysh përsëri përfshijnë: *posedimin ose mungesën e kufijve të vendosur; mënyra e krijimit të Shtetit; nxjerrja e një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme; marrëdhëniet me ish-shtetin sovran; legjitimitetin e shtetësisë; aranzhimet e mbrojtjes me fuqi të tjera; statusi de jure ose de-fakto i aplikantit dhe qeverisë së tij; njohjen e aplikuesit nga Anëtarët e Kombeve të Bashkuara; mirëmbajtja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet e tjera.*[28]

[28] Shih fusnotën 4, fq. 28.

6. Siç është përmendur tashmë, një nga kriteret që janë ekzaminuar në proceset e anëtarësimit të kaluar ka të bëjë me çështjen e marrëdhënies me ish-shtetin sovran ose ish-amë. Në këtë drejtim, procesit i dialogut me Republikën e Serbisë bëhet i rëndësishëm.

7. Duhet shtuar se megjithëse Serbia nuk është anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit dhe nuk mund të paraqesë zyrtarisht pengesë, është aleati i saj historik, Rusia që posedon një fuqi të tillë dhe mund ta përdorë atë në emër të Serbisë ose të pavarur prej saj, për hir të interesave të veta. Kina mund të jetë një kandidat me rezerva, megjithëse pritshmëria është se ka të ngjarë që ajo të abstenojë, ose ka më shumë të ngjarë në krahasim me Rusinë.

8. Një marrëveshje përfundimtare gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përfshirë njohjen e të parës nga kjo e fundit, duhet të përdoret si dëshmi për faktin se çdo ose të gjitha dilemat në lidhje me përmbushjen e kritereve të Kosovës të kërkuara për anëtarësim në KB janë hequr.

9. Autoritetet e Kosovës duhet të kenë parasysh se një marrëveshje me Serbinë nuk çon automatikisht në anëtarësimin e Kosovës në OKB. Megjithëse, një klauzolë e tillë që përshkruan të drejtën e Kosovës për anëtarësim në OKB mund të futet në marrëveshje, vendimi përfundimtar u takon anëtarëve që përbëjnë Këshillin e Sigurimit të OKB-së, veçanërisht ata me fuqi të vetos dhe, pas tyre, anëtarësisë më të gjerë të Asamblesë së Përgjithshme.

10. Paralelisht me procesin e bisedimeve me Serbinë dhe madje edhe pas një marrëveshjeje eventuale, Kosova duhet të ndjekë përpjekjen për njohje dhe veçanërisht anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Bollëku i njohjeve individuale dhe anëtarësimi me një grup të gjerë të institucioneve ndërkombëtare dhe rajonale mund të paktën të zvogëlojnë forcën e çdo

argumenti kundërshtar ose të dekurajojnë çdo rezistencë ose hezitim të mundshëm nga ana e shteteve të tilla si Rusia ose vendeve të tjera kundërshtare.

11. Më në fund, ekziston një alternativë, e cila nuk paraqet anëtarësim të plotë në OKB, dhe ky është statusi i shtetit vëzhgues jo-anëtar. Është e qartë se kjo nuk i plotëson aspiratat e Kosovës për anëtarësim të plotë. Aktualisht, ekzistojnë vetëm dy shtete vëzhguese: Selia e Shenjtë dhe Palestina. Zvicrra e ka ruajtur këtë status derisa të kishte vendosur të bëhej një shtet anëtar i plotë më 2002. Statusi i shtetit vëzhgues jo-anëtar (i ndryshëm nga një kategori tjetër e vëzhguesit jo-shtetëror) i jep të drejtë entitetit të marrë pjesë në punën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, megjithatë me kufizime siç përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme. Vendimi për të dhënë statusin e vëzhguesit merret vetëm nga ky organ dhe merret me shumicë votash. Nuk ka dispozita në Kartën e Kombeve të Bashkuara për statusin e shteteve vëzhguese jo-anëtare, kështu që bazohet thjesht në praktikën e Asamblesë së Përgjithshme.

RIDEA Research Institute of Development and European Affairs

www.ridea-ks.org